

BREAKING NEWS

x

**BILANCI I COVID/ BIEN INFEKTIMET E REJA, MINISTRIA E SHENDETESISE TREGON ÇFA...**

AKTUALITET

## Korçë/ Të maskuar si policë dhe të armatosur, grabitësit lidhin çiftin dhe vjedhin 1.6 milion lekë

SHKRUAR NGA SOT.COM.AL  
8 MAJ 2019

Facebook

WhatsApp

Twitter

Email



Një grabitje me dhunë ka ndodhur mbrëmjen e së hënës në zonën e Korçës, ku pre e grabitjes ka rënë familja Vila. Persona të armatosur dhe të veshur si policë kanë hyrë në banesën e shtetasit Nevruz Vila. Nën kërcënimin e armës autorët kanë lidhur të zotët e shtëpisë dhe i kanë marrë një shumë parash prej 1.6 milion lekësh dhe disa sende me vlerë. Ngjarja e rëndë ndodhi rreth orës 09:00 të mbrëmjes të së hënës pak metra nga aksi rrugorë Pogradec-Korçë, ku tre persona të veshur me uniformën e Forcave të Ndërhyrjes së Shpejtë kanë hyrë në banesën e çiftit duke i

marrë të gjitha paratë e ndodhura në banesë. Menjëherë pasi hynë në banesë grabitësit lidhën dy të moshuarit dhe kanë kërkuar për kasafortën, por pasi nuk e kanë gjetur atë kanë arritur të marrin rreth 1.6 milion lekë të vjetra, para të cilat i zoti i kishte në xhepin e pantallonave. Mësohet se paratë e grabitura ishin nga xhiroja ditore e fituara nga Nevruz Vila. Ai është pronar i një servisi makinash i cili merret me shitjen e gomave të makinave të përdorura të përdorura. Menjëherë pasi kanë marrë paratë autorët janë larguar nga banesa e Nevruz dhe Sadete Vilës duke i lënë të lidhur këta të fundit pa lënë asnjë gjurmë. Çifti i bashkëshortëve, pas ikjes së tre grabitësve kanë kërkuar ndihmën e fqinjëve të cilët kanë lajmëruar menjëherë policinë. Pas marrjes së njoftimit për këtë ngjarje të rëndë uniformat blu të Korçës kanë shkuar menjëherë në banesën e çiftit Vila. Pasi kanë konstatuar se çifti i bashkëshortëve kanë qenë në gjendje të mirë shëndetësore ata i kanë marrë ato në pyetje për të mësuar më shumë në lidhje me autorët. Policia në bashkëpunim me prokurorinë e Korçës kanë nisur hetimet për identifikimin dhe kapjen e autorëve. Dyshohet se autorët kanë pas informacion se Nevruz Vila ka pasur një shumë të konsiderueshme parash në banesë. Sipas policisë ka dyshime se autorët kanë bashkëpunëtor një person tjetër banues në zonë që e njeh familjen Vila, pasi sipas dëshmisë së dhënë të pronarit të banesës se, grabitësit kishin dialekt nga veriu. Hetimet janë ende në vijim dhe policia po punon për identifikimin dhe kapjen e autorëve.

## **Dëshmia e pronarit të banesës**

Në lidhje me ngjarjen e rëndë ka reaguar edhe i zoti i shtëpisë Nevruz Vila. Pas ngjarjes së rëndë ai ka thënë se tre personat kanë hyrë në banesën e tij të maskuar si policë dhe për rreth gjysmë ore i kanë bërë presion psikologjik dhe e kanë dhunuar fizikisht deri sa i kanë marrë paratë në xhep dhe sendet me vlerë. “Rreth orës 09:00 isha duke darkuar ma bashkëshorten. Gati në të mbaruar tek porta u

shfaqën tre persona me uniforma policie. Për një moment thashë është me të vërtetë policia, por pasi hynë në banesë bërtisnin mos lëvizni se ju hodhëm trutë në erë dhe na lidhën së bashku me bashkëshorten. Pasi më lidhën më thanë ku e ke kasafortën? Unë kasafortë nuk kam, nëse gjeni kasafortë më vrisni. Pas kësaj dy filluan kontrollin në banesë ndërsa një tjetër na ruante. Dëgjoja vetëm zhurmë sepse më hodhën mbulesat e divaneve në kokë. Më goditën dy tre herë me tytën e kallashit. Autorët më morën lekët që kisha në xhep si dhe një varëse që e kisha në qafë. Pasi morën paratë ikën dhe në këtë moment i kërkuam ndihmë fqinjëve të cilët më pas lajmëruan policinë. Policia erdhi shumë shpejt pas 5 minutash kanë qenë këtu. Unë isha i lidhur akoma, policia na zgjidhi. Më pas ka ardhur shefa krimesh drejtori i policisë nën drejtori na morën në pyetje dhe nisën hetimet”, ka thënë Nevruz Vila pas ngjarjes së rëndë. Muajit e fundit në aksin Korçë-Pogradec numri i grabitjeve ka qenë gjithnjë e në rritje. Disa banesa e disa biznese kanë rënë pre e grabitësve në këtë zonë gjatë muajve të fundit. Policia ka dyshime se është i njëjti grup që kryen grabitjet në zonën e Korçës, ndërsa policia po punon për identifikimin dhe kapjen e autorëve.

## Elvis Myrta

YOU MAY LIKE

by **mgid**



**Već za 3 dana krvni sudovi će ponovo biti kao sa 20 godina!**

**HYPERTEA**



## Pronađen glavni neprijatelj dijabetesa! Šećer brzo pada do 3,9

DIATEA



## Čaša ujutro sagorijeva 3 - 5 kilograma sedmično

GOSLIM

## Učenik iz Beograd pronašao je najlakši način za mršavljenje

NUTRIVIX



## The Weirdest & Wildest Nail Art Trends

ZESTRADAR



## The Best Pet According To Your Zodiac Sign



## Čišćenje krvnih žila zauvijek, rekao je Paul star 137 godina

HYPERTEA

ZESTRADAR

## The Most Breathtakingly Beautiful Villages In The World

ZESTRADAR



## Men And Women All Over The World Envy This Indian Beauty


ZESTRADAR



## Top 8 Mean Girls In Movies We All Love To Hate

ZESTRADAR

## 8 Grandchildren Who Look Exactly Like Their Famous Grandparents



## Stop aknama,mitiserima, crvenilu. Prirodno, izuzetno efikasno!

MORINGA